Për të ardhmen, planifikojmë ta zgjerojmë listën e partnerëve, donatorëve dhe përkrahësve të ATRC-së, në mënyrë që ta ngritim nivelin e efikasitetit dhe vëllimin e punës sonë. Në të njëjtën kohë, do të vazhdojmë të përmirësojmë Programet tona të trajnimit dhe informimit përfundimtare që përfshinë sa më mirë OJQ-ve të avokimit me resurset që u nevojiten atyre për të qenë më të suksesshëm në punën e tyre. Dhe përfundimtare, pa dyshim se do ta vazhdojmë misionin tonë në zgjimin e avokuesit te secili prej nesh.

Singerisht,
Rreze Duli
Drejtore Ekzekutive ATRC



Hyrje

26

Misioni

Qendra e Trajnimave dhe Burimeve në Avokim (ATRC) është organizatë joftimprurëse kosovare që punon për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si parakusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabilitet rajonal.

ATRC-ja punon me përfaqësues të shoqërisë civile, iniciativave qytetare, subjekteve politike dhe mediave pa dallim feje, përkatësie politike, etnie, moshe, gjinie, aftësie dhe orientimi seksual.

ATRC-ja përmbush qëllimet e veta përmes avokimit, trajnimit, shkëmbimit të informatave dhe rrjetëzimit në Kosovë dhe jashtë saj.



Mbi ATRC-në

27

Qysh prej themelimit në vitin 2001, Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve në Avokim (ATRC) në Prishtinë ka ndihmuar një numër të madh të organizatave joqeveritare (OJQ-ve) në Kosovë për të profesionalizuar punën e tyre, artikular kërkesat e tyre dhe avokuar te strukturat qeveritare rreth çështjeve që ndikojnë tek ato.

Për ta arritur misionin e vet, ATRC-ja organizon trajnime, debate publike dhe mbledhje legislative mbi çështjet e rëndësishme në Kosovë; bashkëpunon me OJQ-të e tjera në tërë Kosovën në fushata të avokimit, të cilat përqëndrohen në zhvillimin demokratik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve; dhe udhëheq me qendrën e burimeve dhe bibliotekën me botime që kanë të bëjnë me çështjet sociale, ekonomike në Kosovë dhe Ballkan.

Gjatë tre viteve e gjysmë të para të saj, ATRC-ja ka qenë partnere implementuese në kuadër të Projektit të OJQ-ve Kosovare për Avokim, projekt ky i përkrahur nga Organizata e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Gjatë kësaj kohe, ka bashkëpunuar ngushtë me Institutin për Menaxhim Lindje-Perëndim (EWMI), i cili ka drejtuar projektin, si dhe me Fondin për Iniciativa Demokratike, një organizatë vendore për dhëni e donacioneve. Gjatë projektit, ATRC-ja ka ofruar trajnime, ngritje kapacitetesh, përkrahje të aktiviteteve të avokimit dhe mundësi shkëmbimi informatash për OJQ-të në tërë Kosovën dhe jashtë saj.

Kah mesi i vitit 2005, ATRC-ja bëhet partnere implementuese në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile, që udhëhiqet nga Bordi për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX) dhe i përkrahur nga USAID-i. ATRC-ja, që atëherë, ka pësuar ndryshime në anëtarësinë dhe personelin e saj, udhëheqjen, bord dhe programe. Ne në ATRC mendojmë se këto ndryshime na kanë lejuar ta përmirësojmë cilësinë e shërbimeve tona. Ne kemi shtuar trajnerë ekspertë të kualifikuar në ekipin tonë, gjë që ka përmirësuar kualitetin e trajnimeve në dispozicion të organizatave joqeveritare në Kosovë. Ne kemi anëtarë të rinj të bordit, të cilët janë kyçur më shumë në dhëni e kontributit dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së organizatës. Departamenti jonë për marrdhënie me publikun ka punuar për t'i dhënë ATRC-së një pamje të re, si dhe për të arritur publik më të madh përmes ndryshimeve në faqen tonë të internetit dhe në butelin.

Përkrahësit

Në mënyrë që të mbahen gjallë programet dhe aktivitetet e ndryshme të saj, ATRC-ja varet nga burimet financiare dhe njerëzore të ofruara nga përkrahësit e saj.

- **Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)**
- **Bordi Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Shkëmbime (IREX)**
- **Instituti i Menaxhimit Lindje-Perendim, Inc. (EWMI)**
- **Fondi Ballkanik për Demokraci (BTD)**
- **Article 19**
- **Komisioni Evropian**
- **Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI)**
- **Instituti IPKO (IPKO)**
- **IDEA Ndërkombëtare (IDEA)**
- **Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)**

Rreth këtij raporti

Raporti vjetor 2005 i ATRC-së, u ofron partnerëve, përkrahësve dhe qytetarëve një pasqyrë të punës dhe aktiviteteve tona. Raporti përshkruan aktivitetet që janë ndërmarrë prej janarit e deri në dhjetor të vitit 2005 në tri programet tona kryesore: Trajnim e ngritje kapacetetesh, Informim dhe Avokim. Të dhënat mbi harxhimet financiare të vitit 2005 dhe kontaktet gjenden në fund të këtij raporti. Informata shtesë rreth ATRC-së mund të gjeni në:

www.advocacy-center.org.

28

Partnerët

Me kalimin e kohës, numri i organizatave dhe institucioneve, që ATRC-ja i konsideron partnerë, është rritur. Në vitin 2005, ATRC-ja ka krijuar partneritete të reja me institucione të ndryshme dhe organe qeverisëse, në përpjekje për të lidhur qytetarët me vendim-marrësit. Partnerët e ATRC-së kanë siguruar përkrahje morale, shkëmbyer eksprtizën dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me ATRC-në në projekte dhe aktivitete të ndryshme.

- **Qendra Kombëtare Shqiptare e Burimeve të Trajnimit dhe Ndihmës Teknike (ANTTARC)**
- **Article 19**
- **Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hetuese (BIRN)**
- **Care International Kosovo**
- **Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore**
- **Instituti i Menaxhimit Lindje-Perndim, Inc. (EWMI)**
- **Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI)**
- **Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jofitimprurës (ICNL)**
- **Bordi Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Shkëmbime (IREX)**
- **Agjencia Kosovare e Eksportit**
- **Instituti Kosovar për të Drejtën e OJQ-ve (IKDO)**
- **Rrjeti i OJQ-ve Kosovare për Avokim (AvoKo)**
- **Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim (KODI)**
- **Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (KWN)**
- **MJAFT! (Shqipëri)**
- **Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan Hope Fellowship**
- **Instituti Kombëtar Demokratik për Çështje Ndërkombtare (NDI)**
- **Klubi Republikan**
- **SFERA – Instituti për Studime Shoqërore dhe të Politikave Publike**
- **Shevolution dhe Eyecatcher Associates (Britani e Madhe)**
- **Stay In Partners (Sipar)**



Programi i trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve

29

Programi i trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve i ATRC-së ka për qëllim t'u sigurojë përfaqësuesëve të organizatave joqeveritare (OJQ-ve) mjetet që u nevojiten për të ndikuar në ndryshime në komunitate tyre. Gjatë katër viteve të fundit, ky program ka ofruar trajnime mbi punën me media, avokimin, menaxhimin e OJQ-ve, planifikimin strategjik, funksionimin e qeverisë dhe tema të ndryshme që kanë të bëjnë me OJQ-të. Pasi që organizatat janë ballafaquar me sfida të reja, ATRC-ja ka modeluar trajnime më të avancuara, enkas të krijuara për të kënaqur nevojat e tyre. Në vitin 2005, ATRC-ja ka ofruar 19 trajnime, në të cilat kanë marrë pjesë më shumë se 397 persona. Trajinimet janë përqëndruar në temat vijuese.

Politikat publike – Trajnim i avancuar

Në janar të vitit 2005, ATRC-ja ka organizuar trajnim tre-ditor të avancuar mbi temën "Politikat Publike". Trajnim i është udhëhequr nga dy profesorë të specializuar në zhvillimin e politikave publike nga Universiteti Shtetëror i Nju Jorkut (SUNY): Profesori Robert T. Nakamura dhe Profesori Mark Baskin. Trajnim i është krijuar enkas për të kënaqur nevojat e të tetë organizatave hulumtuese dhe instituteve, që kanë marrë pjesë në trajnimin. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë analizuar studimet, që disa prej këtyre organizatave i kanë bërë mbi trazirat e marsit 2004 në Kosovë, duke marrë këshilla nga profesorët. Pastaj, trajnimi i është përqëndruar në mënyrat se si të përmirësohet efikasiteti i analizave të bëra nga këto organizata, për t'u adresuar sa më mirë nevojat në Kosovë. Në kontekstin e qeverisë së re të Kosovës, trajnuesit u kanë ndihmuar pjesëmarrësve ta kuptojnë më mirë rolin e analizave të politikave publike në zhvillimin demokratik dhe si të ndikohet në agjendën e politikave publike të qeverisë, duke dhënë ide dhe shembuj nga përvaja e tyre e pasur në këtë drejtim.



30

Si funksionon qeveria: Sistemi i drejtësisë në Kosovë

M 14 shkurt, ATRC-ja ka organizuar një seminar një-ditor me emrin "Si funksionon qeveria: Sistemi i drejtësisë në Kosovë". Seminari u ka ofruar mundësi përfaqësuesve qeveritarë dhe joqeveritarë lokalë dhe ndërkombetarë të shkëmbejnë informata mbi Sistemin juridik në Kosovë. Folësit kanë informuar pjesëmarrësit rreth strukturës së sistemit juridik, problemet me të cilat ballafaqohet sistemi, reformat e planifikuara dhe aktivitetet e OJQ-ve në këtë drejtim.

Shkëmbimi i përvojave: Avokimi në Shqipëri dhe Kosovë

Në shkurt dhe në mars, ATRC-ja ka organizuar një trajnim dy-ditor me emrin "Shkëmbimi i përvojave në avokim ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës". Ky trajnim është organizuar së bashku me lëvizjen "MJAFT!" në Shqipëri. Dy përfaqësues nga lëvizja MJAFT!, Arbjan Mazniki dhe Marinela Lika, kanë udhëhequr trajnimin. Ata ofruan shembuj të mënyrave kreative për t'i mobilizuar qytetarët, ndërmarrë aktivitete avokimi dhe për t'u rrjetëzuar, bazuar në përvojën e tyre. Si vazhdim i kësaj,

përfaqësuesit e Rrjetit të OJQ-ve Kosovare për Avokim (AvoKo) dhe dy anëtarë të ATRC-së kanë bërë një vizitë studimore në Shqipëri, ku kanë parë punën e lëvizjes MJAFT! nga afër.

Si funksionon qeveria: Shërbimi Policor i Kosovës

Më 14 mars, si pjesë e serisë së punëtorive "Si funksionon qeveria", ATRC-ja ka bashkëpunuar me Institutin Kosovar për Hulumtime dhe Dokumentim (KODI) për të organizuar një seminar një-ditor me emrin "Roli i Shërbimit Policor të Kosovës dhe transformimi i saj në të ardhmen". Folësit kanë njoftuar pjesëmarrësit për kompetencat e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK); përpjekjet e Shkollës Policore të Kosovës për të përgatitur policët e SHPK-së për të ardhmen; problemet me të cilat është ballafaquar SHPK-ja; dhe procesin e transformimit të autoriteteve nga UNMIK-u tek institucionet vendore. Gjatë seminarit, KODI ka prezantuar rezultatet e hulumtimeve të bëra në kohët e fundit, duke rekomanduar se do të duhej të formohej Ministria e Punëve të Brendshme, për t'i ofruar shërbime më të specializuara popullit të Kosovës.

Si funksionon qeveria: Ministria për Financa dhe Ekonomi e Buxhet

Më 26 prill, ATRC-ja ka organizuar një seminar informues me temën "Si funksionon Ministria Kosovare për Financa dhe Ekonomi e Buxhet" si pjesë e serisë së punëtorive "Si funksionon qeveria". Agim Krasniqi, Drejtor i Buxhetit Kombëtar sqaroi strukturën dhe punën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Paspyetjeve të pjesëmarrësve, ai shpjegoi procesin buxhetor për komuna. Folësi i dytë, Chris Kaufmann, këshilltar në MEF, foli mbi ekonominë e Kosovës, duke u përqëndruar në balancimin e çështjeve tregëtare. Folësja e tretë, Elmaze Pireva, zëvendëskryetare e Administratës Tatimore të Kosovës, prezentoj një vlerësim të detajizuar se si janë mbledhur taksat, si dhe kërkesat tatimore për OJQ-të.

Monitorimi i politikave publike

Në javën e dytë të majit 2005, në vijim të një numri të madh të trajnimeve paraprake mbi politikat publike të organizuar për aplikantët në programin "Monitorimi i politikave publike" të Fondacionit për Iniciativa Demokratike (FDI), ATRC-ja ka organizuar trajnim dy-ditor, që është përqëndruar në "Monitorimin e politikave publike". Ky trajnim ka pasur në shënjestë OJQ-të, të cilat kanë qenë të përfshira më herët në monitorimin e politikave publike ose që kanë treguar potencial të fort për të punuar në çështjet e politikave publike në të ardhmen. Pjesëmarrësit përvetësuan një kuptim të qartë sa i përket rëndësisë së monitorimit të implementimit të politikave publike dhe kanë përfituar shkathtësi për monitorimin e politikave publike për të ardhmen.

Punëtori trajnimi për aplikantët për donacione të FDI-së

Në nëntor, Grupi trajnues i ATRC-së ka mbajtur pesë punëtori trajnimi me temën "Përpilimin e projekt propozimit". Ky seminar është mbajtur për OJQ-të, të cilat kanë qenë duke përgatitur aplikacionet për donacionet e IREX-it dhe FDI-së për partneritet dhe rrjetëzim. Katër punëtori janë mbajtur në Prishtinë në Qendrën e Trajnimeve të ATRC-së dhe njëri është mbajtur në Mitrovicën veriore. Këto punëtori trajnimi me nivel të lartë interaksioni kanë tërhequr 148 pjesëmarrës nga 108 OJQ, të cilat veprojnë në tërë Kosovën. Gjatë punëtorive, OJQ-të kanë marrë këshilla praktike dhe njohuri përpilimin e projekt propozimeve të tyre. Këto punëtori njëherit kanë qenë aktivitetet e para të ATRC-së në përkrahje të sektorit të OJQ-ve, në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile.

Konsultimet një nga një

Në mënyrë që të sigurohet një ndikim më i madh, ATRC-ja ka nisur një program të ri si pjesë e Programit Kosovar për Shoqëri Civile, duke filluar ofrimin e këshillimeve një nga një për OJQ-të. Përfaqësuesit e OJQ-ve kanë pranuar këshillat e dhëna enkas për nevojat specifike të organizatave të tyre në një sërë çështjesh, si psh. Këshilla për shkruarjen e projekt propozimit, zhvillimin organizativ dhe gjetjen e fondeve. Gjatë vitit 2005, shtatë OJQ kanë perfituar nga shërbimet e këshillimeve të ATRC-së. Njëra nga to është edhe Rrjeti i Rinisë së Kosovës, i cili si rezultat, ka arritur të fitojë donacion nga Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FID), në kuadër të programit IREX/KCSP.





Programi për informim

32

Programi për informim i ATRC-së përkrahë shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve të qeverisë, zyrtarëve të zgjedhur dhe qytetarëve përmes diskutimeve publike, mbledhjeve legjislativë, konferencave, buletinit të përmua jshëm dhe faqës së internetit të ATRC-së. Diskutimet publike, shpesh të organizuara në bashkëpunim me OJQ-të e tjera, zyrat qeveritare apo ekspertë të ndryshëm, kanë për qëllim të informojnë qytetarët mbi çështjet kyçë që ndikojnë në jetën e tyre. Në vitin 2005, ATRC-ja ka organizuar 14 diskutime, debate dhe seminare me temat e mëposhtme.

Konferanca e përfundimit të Projektit të OJQ-ve Kosovare për Avokim

Ndërtimi i demokracisë përmes avokimit nga baza – Përvoja e Kosovës

Kjo konferencë, e organizuar më 5-6 maj 2005, ofroi mundësinë e analizimit të katër viteve të punës avokuese të OJQ-ve kosovare, që ishin mbështetur nga KNAP-i – Projekti i OJQ-ve Kosovare për Avokim. KNAP ishte marrëveshje bashkëpunimi në mes USAID-it dhe Institutit të Menaxhimit Lindje-Perndim, Inc. (EWMI). Projekti implementohej nga Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI) në Gjakovë dhe Qendra e Trajnimave dhe Burimeve në Avokim (ATRC) në Prishtinë.

Pjesëmarrës ishin anëtarët dhe udhëheqësit e OJQ-ve kosovare, zyrtarët publikë dhe politikanët nga niveli lokal dhe qendror, si dhe OJQ-të dhe donatorët ndërkombëtarë. Kryeministri i Kosovës, Bajram Kosumi, e dha fjalën hyrëse. Në ditën e dytë, Kryesuesi i Zyrës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Phillip Goldberg ishte mysfir special.



Përfaqësuesit e OJQ-ve i prezantuan përvojat e tyre të avokimit përritjen e pjesëmarrjes publike në vendim-marrje dhe përvojat e tyre në ndërtimin e institucioneve dhe praktikave demokratike në Kosovë.

Pjesëmarrësit identifikuan strategji të suksesshme përmirësimin e mëtejmë të efikasitetit të përpjekjeve të avokimit në Kosovë. Si përfundim, ata përpiluan një listë rekondimesh konkrete përritjen e kapaciteteve të OJQ-ve përritjen e avokimit; 2) krijimin e strategjisë përritjen e avokimit në nivelin lokal; 3) krijimin e strategjisë përritjen e avokimit në nivelin qendror dhe tek UNMIK-u dhe 4) mobilizimin e qytetarëve përritjen e avokimit në vendim-marrje.

Uji nga bunarët rrezikon jetërat

Organizata vendore "Ujë përritjen e Mileniumin e Ri" ka prezantuar rezultatet e hulumtimit të saj në debatin publik të organizuar në ATRC, në janar. Debat bashkoi përfaqësues nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare së bashku me specialistë nga institucionet qeverisëse përritjen e diskutuar brengat mbi ambientin në Kosovë. Në diskutim, pjesëmarrësit mësuan përritjen e prezente që kanë të bëjnë me ndotjen e ujit në Kosovë. Debat është ndjekur nga disa media.

Projektligji mbi Lirinë e Asociimit përritjen e OJQ-të

Në shkurt, ATRC-ja ka organizuar një debat publik në mënyrë që të informonte anëtarët e OJQ-ve vendore përritjen e ligjit të ri mbi lirinë e asociimit përritjen e OJQ-të. Qëllimi i debatit ka qenë që OJQ-ve t'u shpjegohen kushtet brenda ligjit, gjithashtu edhe të ngritet vetëdija a tyre mbi ndikimin e ligjit të propozuar në aktivitetet e tyre. Ky debat është mbuluar nga shumë media, si nga gazetat ashtu edhe televizioni. Më pas, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare janë bashkuar në përpjekje të parandalimit të promulgimit të ligjit dhe të avokimit përritjen e ndryshime te dispozita brenda ligjit.

Si funksionon sistemi i pagesës në Kosovë

Në mars, ATRC-ja dhe Klubi i Biznesit Prizren (KBP) kanë bashkë-organizuar diskutimin publik "Si funksionon sistemi i pagesës në Kosovë". Në debat, KBP-ja prezentoj studimin e tyre mbi vonesat në transakcionet bankare në Kosovë. Debat bashkoi përfaqësues nga institucionë të ndryshme që kanë të bëjnë me transaksionet e parave përbrenda ose ndërmjet bankave për të diskutuar se cili institucion ishte përgjegjës për vonesat e transaksioneve. Morën pjesë OJQ të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe përfaqësues nga Oda Ekonomike dhe Banka Botërore.



Decentralizimi dhe pilot projekti

Në prill, ATRC-ja ka organizuar diskutimin publik "Decentralizimi dhe pilot projekti" në mënyrë që OJQ-të dhe populli të informoheshin për zhvillimet e fundit rreth këtij plani tejet kontraverz. Ky ishte debati i parë që ka pasur të bëjë me këtë çështje dhe në të kanë marr pjesë më shumë se 30 anëtarë të organizatave vendore dhe ndërkombëtare. Mediat vendore, të përditshmet "Lajm" dhe "Koha Ditore", e kanë përcjellur këtë debat.



Standardet: Pse janë të rëndësishme përmua?

34

Në maj, AvoKo ka organizuar një debat publik rreth standardeve për Kosovën në ATRC. Ky debat bënte pjesë në serinë e debateve që AvoKo ka mbajtur në 15 komuna përreth Kosovës si pjesë e fushatës së financuar nga Projekti i OJQ-ve Kosovare për Avokim të quajtur "Standardet: "Pse janë të rëndësishme përmua?" Në debat, Zëvendës Kryeministri Adem Salihaj dhe Zëvendës Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shefki Gashi, prezantuan perspektiven e institucioneve qeverisëse për standardet. Florina Duli nga Klubi Republikan prezantoj perspektivën e OJQ-ve. Përfaqësues të ndryshëm OJQ-sh morën pjesë në këtë debat, i cili ishte përcjellur nga e përditshmja "Koha Ditore" dhe RTV21.

Seminari mbi drejtësinë në tranzicion

Më 4-5 prill, KODI, ATRC-ja, Klubi Republikan dhe Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë në Tranzicion kanë organizuar një seminar me emrin "Drejtësia në tranzicion: Copëza e enigmës së Kosovës që mungon". Konferenca e mbajtur në Hotelin Grand në Prishtinë, ka pasur për qëllim të prezentojë konceptin e drejtësisë në tranzicion në Kosovë. Kryeministri Bajram Kosumi dhe Kryesuesi i Zyrës së Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Phillip Goldberg e kanë hapur seminarin. Më





shumë se pesëdhjetë njerëz morën pjesë në seminar, i cili është përcjellur nga mediat elektronike dhe ato të shtypura.

Çështjet e sigurisë në Kosovë

Në maj, ATRC, FDI, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hetuese, Klubi Republikan dhe Rrjeti i Grave të Kosovës organizuan diskutim publik mbi çështjet e sigurisë që ndikojnë te qytetarët kosovarë. Folësit ishin Jakup Krasniqi – Deputet i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, Gjylnaze Syla – Deputete e Kuvendit të Kosovës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Teuta Sahatçiu – Deputete e Kuvendit të Kosovës nga Partia Reformiste ORA, si dhe përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe institucionet e sigurisë. I tërë debati, i prezantuar nga Jeta Xharra, është shfaqur në televizionin publik – RTK.



Publikimi i IDEA-së Ndërkombëtare mbi demokracinë lokale

Në fillim të majit, ATRC-ja përktheu dhe botoi një dokument të shkruar nga Dr. Mark Baskin me emrin "Zhvillimi i demokracisë lokale në Kosovë" si pjesë e Programit të IDEA-s Ndërkombëtare për Ndërtimin e Demokracisë dhe Menaxhimin e Konfliktit. Dokumenti është shkruar si rezultat i konkluzioneve të një seminari për demokracinë lokale kosovare, të mbajtur më 20-21 nëntor 2003 në Qendrën e Qeverisjes së Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Oslo, Norvegji. Botimi është bërë në gjuhën shqipe dhe në atë serbe.

Filmi dokumentar i Projektit të OJQ-ve Kosovare për Avokim

ATRC-ja ka bërë një film dokumentar 30-minutësh me emrin "Ndërtimi i demokracisë përmes avokimit nga baza", i cili rrëfen mbi projektet e finançuar nga Projekti i OJQ-ve Kosovare për Avokim, i cili synonte të ndikonte vendimmarrjen në qeverinë komunale dhe kombëtare të Kosovës. Filmi u shfaq më 30 maj 2005 në ATRC. Në të njëjtën kohë, ATRC-ja ka prezantuar publikisht Raportin vjetor të saj për vitin 2004, si dhe publikimin e IDEA-s Ndërkombëtare "Ndërtimi i demokracisë lokale në Kosovë".

Këshilli Anti-Korrupsion i Kosovës

Në tetor, ATRC-ja ka ndihmuar zgjedhjen dhe nominimin e kandidatëve të shoqërisë civile për antarë në Këshillin e Agjencionit Anti-Korrupsion të Kosovës, që funksionon në kuadër të Qeverisë. Përfaqësuesit e OJQ-ve të cilët morën pjesë në mbledhje, votuan në favor të formimit të një koalicioni për



aktivitete anti-korrupsion. Ata theksuan nevojën për të përfshirë organizatat e mediave në koalicion, duke e pasur paraqysh rolin qenësor të mediave në luftimin e korrupsionit në Kosovë. Pjesëmarrësit gjithashtu u pajtuan rreth parimeve të koalicionit dhe funksioneve fillestare. Përfaqësuesit e OJQ-ve zgjodhën Bashkim Rrahmanin, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit për Iniciativa Demokratike, si përfaqësues të shoqërisë civile në këtë koalicion. ATRC-ja do të vazhdojë të ofrojë ndihmë për aktivitetet në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

Prezentimet e donacioneve të Fondacionit për Iniciativa Demokratike

Në nëntor, në kuadër të Programit Kosovar për Shoqëri Civile, të përkrahur nga USAID/IREX, përfaqësuesit e ATRC-së, FDI-së dhe IREX-it mbajtën shtatë mbledhje informimi për të prezantuar kriteret për donacione, udhëzimet për projekt propozime dhe kushtet e tjera për organizatat e interesuara për aplikim për donacionet e FDI-së. Në këto prezentime u shpërndanë materialet e aplikimit për programin e donacioneve të FDI-së për partneritet dhe rrjetëzim, të lansuar në nëntor. Mbledhjet kanë qenë të hapura për të gjitha OJQ-të vendore, që kanë dëshmuar se kanë partneritete dhe janë rrjetëzuar me OJQ dhe sektore të tjera. Fushat nën shënjestë të donacioneve të FDI-së ishin: transparenca dhe antikorrupsioni; zhvillimi i komunitetit; dhe pajtimi ndretnik e zbutja e konfliktit.

Korrupsioni në shoqërin tonë: Cfarë duhet bërë për ta luftuar?

Në dhjetor, ATRC-ja ka organizuar një debat në lidhje me çështjen e korrupsionit në Kosovë. Qëllimi i debatit ka qenë të diskutohen dhe rishikohen mekanizmat e tanishëm dhe ata potencialë për të ardhmen për ta luftuar korrupsionin në Kosovë. Shumica e panelistëve dhe pjesëmarrësve u pajtuan rreth mënyrave më efikase për ta luftuar korrupsionin: të zbatohet Ligji Anti-korrupsion në fuqi; të ndiqen penalisht personat e korruptuar; të ndërtohet një koalicion i gjerë kundër korrupsionit; dhe të mbahen më shumë debate mbi këtë çështje. Gjatë kësaj ngjarjeje, ATRC-ja ka ndihmuar në promovimin e Organizatës lokale të apo krijuar për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – “Çohu”.

36

Sistemi pensional në Kosovë: Sukses apo dështim?

Në dhjetor, ATRC-ja dhe KODI kanë organizuar një debat, që ka bashkuar pensionerët dhe institucionet përgjegjëse për pensione për t'u adresuar së bashku çështjet në lidhje me kualitetin e shërbimeve pensionale në Kosovë. Shumica e pjesëmarrësve kanë ardhur në përfundim se sistemi pensional në Kosovë është një dështim total dhe se pozita e pensionerëve në shoqëri duhet të përmirësohet. Pjesëmarrësit u pajtuan se diskutimet në lidhje me këtë çështje duhet të vazhdojnë dhe se duhet të krijohet një koalicion i OJQ-ve për avokim në interes të pensionerëve. ATRC-ja synon të vazhdojë punën me institucionet që administrojnë pensionet dhe gjithashtu me pensionerët të organizuar në asociacione formale dhe joformale për të adresuar çështjet specifike në lidhje me pensionet në Kosovë.

Diplomacia, negociatat dhe shoqëria civile

Në dhjetor, ATRC-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët me organizata vendore dhe me z. Miroslav Lajcak, Drejtorin Gjeneral për Çështjet Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Sllovenske. Diskutimi është përqëndruar në rolin që ka shoqëria civile në krijimin e themelive për një Kosovë multietnike. Gjithashtu prezente në panel ishte edhe znj. Eliska Slavikova, përfaqësuese e Shoqatës Njerëzit e Rezikuar, një OJQ me seli në Bratislavë, Sllovakia. Z. Lajcak tregoi përvojën nga shteti i tij, ku OJQ-të sllovake janë bërë partnere me qeverinë rreth kësaj çështjeje. Qeveria e Sllovenske në bashkëpunim me Shoqatën Njerëzit e Rezikuar kishin ofruar të organizonin një mbledhje në Bratislavë ndërmjet OJQ-ve kosovare dhe atyre serbe për të diskutuar mbi mënyrat e komunikimit në mes vete. Delegacioni sllovak gjithashtu përmendi mundësitetë për financim nga qeveria e Sllovenske.



ATRC - Advocacy Training & Resource Center

http://www.advocacy-center.org.org/Comments/index.html

(Sunday, 24.09.2006 - 10:19:09 AM)

atrc

Back to ATRC Home Page

Logout

Home About Us Services Information Grants Training Events Resources Directory

USAID
U.S. Agency for International Development
IREX

ATRC is supported by USAID and IREX

Vacancy Announcement: Subgrant Finance Manager

Call for Proposal

ATRC announces a Request for Applications (RFA) for the third round of the REINFORCES Civil Society Program: Partnership and Networking Grants for NGOs in Kosovo.

Kosovo Civil Society Program (KSCP) is a three year initiative funded by United States Agency for International Development (USAID) and implemented by the International Foundation for Adelphi and Exchange (IFAE). The goal of this program is to further strengthen the role of Kosovo civil society and the NGO community in becoming a vibrant and viable sector that plays a significant role in representing Kosovo's diverse citizens and shaping public policy.

Grant Structure and Values:

The partnership and networking grants will be awarded to eligible NGOs whose activities concern a strong partnership and networking component between NGOs and NGOs and other sectors (such as governmental, private business sector), as well as address critical issues in one of three grant target areas: Transparency and Anti-Corruption, Community Governance or Environment and Natural Resource Management. Duration of these grants is 6 to 12 months. NGOs are eligible to apply for grants ranging in size to \$ 25,000. Deadline for submission is 31 October, 2006.

RFA Package: A comprehensive and detailed RFA Package (including Eligibility Criteria, Application Details, Application Form, Selection Criteria and Review Process, Request Application Form, and Proposal Guidelines and Format).

[Click here to download application, selection criteria](#)

Upcoming Events

- October 14-16: ATRC Training: Introduction to Advocacy and Coalition Building
- October 15-16: the Senior Team (11:00-13:00)
- October 16-18: Workshop on Project Proposals Writing

Recent Events

- September 20: Conference "National Anti-corruption Strategy that must be translated into policies" organized by National Democratic Institute (NDI) in cooperation with USAID-KICP and ATRC.
- September 20: Round Table "Transparency and Anti-corruption in the Public Sector" organized by the National Assembly with members of State delegation and Minister (Judi-Hekim).
- September 20-21: Regional Conference on Good Governance, organized by the Office of Prime Minister, UNDP Kosovo and the Advocacy Training Resource Center.
- September 20: E4 Training Workshop on Project Proposal Writing

Buletini i ATRC-së "Avokimi"

37

ATRC-ja ka vazhduar publikimin e buletinit të saj të përmuajshëm elektronik "Avokimi". Në vitin 2005, është shtuar një dimension i ri në buletin. Tani, ai ofron udhëzime praktike dhe informata, të cilat mund të përdoren nga OJQ-të vendore dhe grupet e tjera të interesuara gjatë punës së tyre. Secilin muaj, "Avokimi" u është dorëzuar në mënyrë elektronike qindra OJQ-ve dhe përkrahësve potencialë në tërë Kosovën, si dhe ndërkombëtarisht. "Avokimi" publikohet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Duke filluar nga numri i majit, "Avokimi" gjendet në faqet e internetit të ATRC-së dhe FDI-së: www.advocacy-center.org.org dhe www.fdi-kosovo.org.

Faqja e internetit të ATRC-së: www.advocacy-center.org.org

Në vitin 2005, ATRC-ja filloj procesin e zgjerimit të faqës së internetit për ta bërë atë më atraktive dhe relevante për përdoruesit e saj. Prej 1 tetorit, ATRC-ja ka pasur 1,432 vizitorë në faqën e saj të internetit



Programi i avokimit

38

Në përpjekje për të siguruar pjesëmarrje sa më të madhe të qytetarëve në ndërtimin e institucioneve dhe praktikave demokratike në Kosovë, ATRC-ja përkrahë organizatat që ndikojnë në ndryshime përbredhëse komuniteteve, komunave të tyre, Kosovës dhe rajonit duke siguruar forum përrjetëzim, shkëmbimin e informatave dhe aktivizëm nga baza përmes Programit të saj të avokimit. Gjatë vitit 2005, ATRC-ja ka qenë e kyçur në projektet vijuese të avokimit.

Fushata e Rrjetit AvoKo për ngritje të vetëdijes mbi standardet

I përkrahur nga ATRC-ja, në prill dhe maj të vitit 2005, Rrjeti i OJQ-ve Kosovare për Avokim (AvoKo) ndërmori fushatën për ngritjen e vetëdijes së popullatës rreth standardeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për Kosovën. Në standarde përfshiheshin tetë objektiva të caktuara nga OKB-ja, realizimit të së cilave kosovarët duhej t'i afroheshin, në mënyrë që diskutimet mbi statusin final politik të Kosovës të fillonin. Qëllimi i kësaj fushate ka qenë të rritjej përkrahja e qytetarëve për procesin e implementimit të standardeve duke rritur njohurinë e popullit rreth asaj se çfarë kërkohet nga Standardet për Kosovën në terme konkrete dhe konteksttin e gjërë të procesit. Pesëmbëdhjetë debate publike me temën "Standardet: Pse janë të rëndësishme përmirësuar?" janë organizuar në 15 komuna ku kanë marrë pjesë përafersisht 500 persona.

Përveç kësaj, është botuar edhe një broshurë me të dhëna mbi tetë standardet e OKB-së për Kosovën. Broshura sqaronë rëndësinë e përmbytjes së standardeve dhe rolin e qytetarëve në procesin e implementimit të tyre. Broshurat janë shpërndarë nëpër tërë Kosovën. Një shpallje televizive është shfaqur ku Kryeministri Bajram Kosumi, Komandanti i Trupave Mbrojtëse të Kosovës Gjeneral/Lejtnant Agim Çeku dhe përfaqësuesja e shoqërisë civile Igballe Rogova, kanë inkuruar qytetarët që të përkrahin procesin e implementimit të standardeve.



Implementimi i Ligjit për qasje në dokumente zyrtare

39

E përkrahur nga Komisioni Evropian dhe Article 19, në kuadër të përpjekjeve rasonale për të implementuar Ligjin për qasje në dokumente zyrtare, ATRC-ja ka bërë një kërkesë për dokumente zyrtare në Ministrinë e Kulturës brenda Institucioneve të Pérkohshme të Vetë-Qeverisjes (IPVQ). Kërkesat kanë qenë në lidhje me dokumentet për ngjarjen kulturore "Kënga Magjike" të financuar nga ministria. ATRC-ja ka bërë kërkesën për ta parë se a janë shpenzuar si duhet fondet për këtë ngjarje. Pas përpjekjeve të shumta, ATRC-së ende nuk u është aprovuar leja për të parë këto dokumente publike. ATRC-ja ka shfrytëzuar këtë përvjetorë për ta krijuar një rast studimi për përdorim të mëtutjeshëm gjatë aktiviteteve të avokimit për lirinë e informimit.

Si pjesë e projektit, ATRC-ja gjithashtu ka organizuar dy seminare dy-ditore të quajtura "Liria e informimit në Kosovë: Si mund t'a përdorim Ligjin për qasje në dokumente zyrtare".

ATRC-ja gjithashtu ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për implementimin e Ligjit për qasje në dokumente zyrtare në Kosovë me Kryesuesin e Zyrës për Qeverisje të Mirë brenda zyrës së Kryeministrit.

Në mënyrë që të vlerësohej vetëdija dhe perceptimet mbi Ligjin për qasje në dokumente zyrtare në Kosovë, ATRC-ja e ka angazhuar kompaninë Index Kosova për ta bërë një hulumtim të opinionit publik me qytetarë dhe me zyrtarë publik. Rezultatet kualitative dhe kuantitative nga hulumtimet e bëra do t'i ndihmojnë ATRC-së ta zhvillojë fushatën për qasje në dokumente zyrtare me qëllim të përkrahjes së implementimit të këtij ligji. Fushata do të ndërmirret në bashkëpunim të ngushtë me zyrat e qeverisë, të cilat janë përgjegjëse për implementimin e këtij ligji.

Avokimi kundër Ligjit për OJQ-të

Pasi që Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e lirisë së asociimit për OJQ-të, ku përfshihen amendamente që shkojnë ndesh me legjislacionet ndërkombëtare mbi lirinë e asociimit, ATRC-ja, Instituti Kosovar për të Drejtën e OJQ-ve (IKDO) si dhe Këshilli i Mbrojtës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ), i dërguan një peticion Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të UNMIK-ut dhe zyrës së tij ligjore. Më shumë se 120 OJQ nënshkruan peticionin. Peticioni është prezantuar në mars, në takimin me Këshilltarin Ligjor të PSSP-së, Alexander Borg-Olivier. Në këtë takim, pasi që dëgjoi argumentet e përfaqësuesve të OJQ-ve, ai tha se UNMIK-u do të intervenonte vetëm në rastet e shkeljes së Kornizës Kushtetuese ose të Rezolutës 1244. Megjithëse ai u pajtua me delegacionin e OJQ-ve, ai prapë se prapë tha se në këtë rast nuk e shihte një arsy të fortë për kundërshtimin e ligjit dhe kthimin e tij prapa nga PSSP-ja. Grupi i OJQ-ve i dërgoi Alexander Borg-Olivier-it argumente shtesë në lidhje me amandamentet në fjalë.

Koalicioni Anti-korrupsion

Më 8 shkurt, ATRC-ja ka organizuar një sesion planifikues në liqenin e Batllaves së bashku me koalicionin anti-korrupsion, kupërfshiheshin përfaqësues nga qeveriadhe shoqëria civile. Qëllimi i sesionit ka qenë të planifikohet fushata vetëdijësuese dhe programi i trajnimit kundër korrupsionit. Sesioni është financuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Drejtori i Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim dhe Drejtori i ATRC-së bashkëpunuan për të hartuar Planin kosovar të veprimit kundër korrupsionit për qeverinë e Kosovës në kuadër të Programit të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Evropën Juglindore (PACO).

Vizitat studimore të AvoKo-s tek lëvizja "Mjaft!" në Shqipëri

Në prill, përfaqësues nga pesë organizata anëtarë të AvoKo-s udhëtuan në Tiranë për një vizitë studimore tri-ditëshe, gjatë së cilës u takuan me përfaqësuesit e "Mjaft!"-it dhe partnerët e tyre. Takimet gjatë vizitës studimore ishin përgatitur për t'i përbushur nevojet individuale të anëtarëve të AvoKo-s. Ato përfshinë bisedime mbi fushatat potenciale të avokimit, me specialistë të ambientit, edukimit, zhvillimit dhe çështjeve ligjore. Anëtarët e AvoKo-s dhe "Mjaft!"-it diskutuan mundësinë e bashkëpunimit në një fushatë të përbashkët avokimi. Gjatë vizitës studimore, anëtarët

e AvoKo-s u takuan edhe me Edi Ramën, Kryetarin e Tiranës. Mjaft! dhe AvoKo planifikojnë të vazhdojnë bashkëpunimin e tyre në të ardhmen.

Rritja e pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje

Në partneritet me Fondacionin për Iniciativa Demokratike (FDI), ATRC-ja implementoi një projekt që kishte për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje. Qëllimi i Projektit të Pjesëmarrjes Publike, të financuar nga Trusti Ballkanik për Demokraci, ka qenë që të rrissë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje, përmes donacioneve për OJQ-të, trajnimit të zyrtarëve komunalë dhe shoqërisë civile, si dhe diskutimeve publike.

Si pjesë e projektit, në mars ATRC-ja ka organizuar gjashtë trajnime në tri komuna: Klinë, Istog dhe Dragash. Gjithsej, 70 veta morën pjesë. "Si ta përkrahim pjesëmarrjen publike" dhe "Ndërtimi i marrëdhënieve me qytetarët për pjesëmarrje më të mirë publike" kanë qenë temat e trajnimeve, që u janë ofruar zyrtarëve komunalë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në këto komuna. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë të rritjet kapaciteti dhe dijenia e OJQ-ve, qytetarëve dhe zyrtarëve të qeverisë mbi rëndësinë e rritjes së pjesëmarrjes publike në vendim-marrje. Trajnerët, Enver Hasani (Profesor në Universitetin e Prishtinës) dhe Emrush Azemi (trajner nga Projekti i OJQ-ve Kosovare për Avokim) u kanë ofruar pjesëmarrësve shembuj të përkrahjes së pjesëmarrjes publike në shtetet e tjera. Ata gjithashtu kanë ndihmuar pjesëmarrësit në planifikimin e aktiviteteve që ata do të mund t'i ndërmerrin sipas nevojave të tyre.

Komponent tjetër i Projektit të pjesëmarrjes publike kanë qenë edhe debatet publike, të cilat janë organizuar në katër qytete: Klinë, Istog, Dragash dhe Prishtinë. Qëllimi i këtyre debateve ka qenë të ngritjet vetëdija e popullatës për aprovimin e rregullores përfshirjen e pjesëmarrjes publike në vendim-marrjen lokale.

Duke përcjellur shembullin e komunës së Deçanit dhe Vitisë, ku këto lloj rregulloresh janë aprovuar më parë, me përkrahje të FDI-s dhe ATRC-së, OJQ-të nga komunat e Dragashit, Klinës dhe Istogut me sukses kanë avokuar për rregullore të njashme në mbledhjet e tyre komunale. Ata kanë pasur përkrahjen nga OJQ-ja Syri i Ardhmërisë nga Peja. Këto rregullore sigurojnë që qytetarët të marrin pjesë në mbledhjet komunale, të kontaktojnë zyrtarët e tyre lokalë dhe të kenë qasje në të gjitha dokumentet zyrtare.

Deklaratat financiare



Bashkim Uka
Licensed Auditor
Radovan Zogovic # 8
Qytetza Pejton,
Pristine
Kosovo- UNMIK
Phone: + 377 44 222 562
Central Fax: + 381 38 249 043

April 4, 2006

Attn: ATRC Board of Directors
Rr. Agim Ramadani, 15 (2nd Floor)
Prishtina - Kosova

We have audited the financial statements and supplementary financial data of Advocacy Training and Resource Center (ATRC) expressed in EUR, for the period January – December 31, 2005. These financial statements and supplementary financial data are the responsibility of the project's management. Our responsibility is to express an opinion on the aforementioned financial information based on our audit.

We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing (ISA). Those standards require that we plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the reporting forms are free of material misstatement. An audit includes examining, on a test basis, evidence supporting the amounts and disclosures in the reporting forms. An audit also includes assessing the accounting principles used and significant estimates made by management, as well as evaluating the proper accounting and reporting of the data on the financial statements. We believe that our audit provides a reasonable basis for our opinion.

In our opinion, the financial information present fairly, in all material respects, the financial position of ATRC as of December 31, and the results of operations in accordance with International Standards of Accounting and Kosovo Standards of Accounting.

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Bashkim Uka'.
Bashkim Uka



Për periudhën
Janar - Dhjetor 31, 2005

Bilanci Pasuror

Zotërimet	Shënim	EUR	Detyrimet	Shënim	EUR
Para të gatshme	1	25,494.34	Llogari detyrimi		0
Ilogari arkëtimi			Detyrime grantesh		0
Vlerënota për t'u arkëtar			Prurje të mëvonshme		0
Inventari			Hipotekë dhe vlerënota për pagesë		0
Investimet			Detyrime të tjera		0
Të sigura			Detyrime gjithsej		0
Të tjera					
Toka, ndërtesa dhe pajisje	2	9,053.31	Bilanci i fondeve		
Zotërimet të tjera	2	14,519.89			
			Bilanci i fondeve më 1 janar 2005	3	74,135.75
			Teprica (nga llogaria e fitimit dhe e të ardhurave)		-25,068.21
			Bilanci gjithsej		49,067.54
Zotërimet gjithsej		49,067.54	Detyrimet dhe bilanci i fondeve gjithsej		49,067.54

42

Llogaria e fitimit dhe e të ardhurave

Të hyrat	Shënim	EUR	Shpenzimet	Shënim	EUR
Kontributet, dhuratat ose grantet	4	177,082.55	Shërbimet e programit	5	152,257.2
Pagesat dhe të hyrat nga veprimtaritë	4	1,560.00	Menaxhmenti dhe administrata		51,453.57
Të pritshme për arkëtim			Shpenzime të tjera		
Pjesë fitimi dhe interesat					
Qira					
Të ardhura të tjera nga investimi			Shpenzimet gjithsej		203,710.76
Shitje e zotërimeve					
(minus koston e shitjeve)			Të ardhurat neto nga operacionet		-25,068.21
Të hyra nga ngjarjet speciale					
Shitjet me shumicë të inventarit					
(minus koston e mallrave të shitur)					
Të hyra të tjera			Taksa		
Të hyrat gjithsej		178,642.55	Të ardhurat neto		-25,068.21

Anëtarët e bordit të ATRC-së

Igballe Rogova

Drejtore Ekzekutive; Rrjeti i Grave të Kosovës

Ilaz Ramajli

Avokat; Ramajli dhe Partnerët

Sejdi Osmani

Drejtëor administrativ; RIINVEST

Petrit Selimi

Projekti i mediave

Anton Berishaj

Profesor; Universiteti i Prishtinës

Stafi ATRC-së

Drejtore ekzekutive

Reze Duli

rreze@advocacy-center.org

Menaxher finansiar dhe administrativ

Gani Asllani

gani@advocacy-center.org

Trajnere dhe menaxhere këshilltare

Donika Podrimja-Salihu

donika@advocacy-center.org

Trajnere dhe këshilltare

Afërdita Surroi

aferdita@advocacy-center.org

Trajner dhe këshilltar

Kushtrim Islami

merita@advocacy-center.org

Përgjegjëse programesh

Natyra Zhjeqi

natyra@advocacy-center.org

Menaxhere komunikimi dhe pune me jasht

Arjeta Doroci

arjeta@advocacy-center.org

Menaxher për teknologji informative dhe databaza

Arsim Kosumi

arsim@advocacy-center.org

Informatat e kontaktit:

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve në Avokim

Rr. Agim Ramadani, Nr. 15, Prishtinë, Kosovë

Tel/fax: +381 38 244 810

info@advocacy-center.org

www.advocacy-center.org

43



44

Ky raport është mundësuar financiarisht përmes përkrahjes së ofruar nga populli Amerikan përmes Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), si dhe Bordi Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Shkëmbime (IREX), nën kushtet e marrëveshjes së bashkëpunimit për Projektin Kosovar për Shoqëri Civile. Opinionet e shprehura në këtë publikim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht qëndrimet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2005, ATRC- Qendra e Trajnimive dhe Burimeve në Avokim, Prishtinë - Kosovë
ATRC Raporti Vjetor 2005 Përgatitur nga: Natyra Zhjeqi; Editor: Nicole Farnsworth; Koncepti dhe dizajni: Bujar Kabashi dhe Kreshnik Berisha.



Advocacy Training and Resource Center

Rr. Agim Ramadani, Nr. 15, Prishtina, Kosovo

Tel/fax: +381 38 244 810

info@advocacy-center.org

www.advocacy-center.org

ANNUAL
REPORT

RAPORTI
VJETOR

GODIŠNJI
IZVEŠTAJ

atrc.

Advocacy Training & Resource Center



atrc.

Centar za Obuku i Resurse u Zastupanju
Godišnji Izveštaj 2005



SADRŽAJ

Pismo izvršnog direktora	3
Uvod	4
Misija	4
O ATRC	5
Podržavaoci	6
Partneri	6
O ovom izveštaju	6
Obuka i Nadgradnja Kapaciteta	7
Program Informisanja	10
Javne rasprave	10
ATRC bilten "Zastupnik"	15
ATRC web-sajt	15
Program Zastupanja	16
Finansijske Izjave	19
Odbor	21
Personal i Kontakt Informacije	21
Godišnji Izveštaj 2005	ATRC

Pismo izvršnog direktora

Godina 2005. pratila je dve izuzetno aktivne godine za ATRC, koje su pomogle da se sama organizacija utvrdi kao jedna od najuticajnijih i najaktivnijih NVO za zastupanje na Kosovu. Šta je učinilo nivo rada prethodnih godina teškim za dostizanjem, takođe je bila i činjenica da je 2005. bila godina tranzicije za ATRC. Ovo je bilo vreme kada se završio trogodišnji Projekat kosovskih NVO u zastupanje (KNAP) finansiran od USAID-EWMI i kada je započeo Kosovski program civilnog društva (KCSP) sa novim partnerstvom između USAID i IREX.

Ono o čemu smo morali da vodimo računa je da učinimo ovu tranziciju što je moguće bezbolnjom, tako da naša misija ne trpi nikakve posledice. Pokazalo se da ovo nije bilo tako lako, kao što se na početku činilo, obzirom da se podudarilo sa fundamentalnim promenama u strukturi ATRC. Ovo je uključivalo promenu Odbora ATRC, kao i brojne promene u sastavu osoblja, uključujući naimenovanje Izvršnog direktora, preuzimajući od Kreshnik Berisha-e, što je sve ukupno kao mogućnost imalo stvaranje neprijatnog vakuma. Ipak smo iskoristili ovu situaciju, na taj način što smo revidirali našu poziciju i kapacitete i preduzeli neophodne promene za nastavak doprinosa u stalno promenljivom okruženju NVO. Na ovaj način smo ojačali našu komponentu izgradnje kapaciteta, uspostavljajući mogućnost obuke u prostorijama naše organizacije sa 4 trenera u punom radnom odnosu kod ATRC i gde smo reorganizovali ATRC skoro od početka.

